

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6229
E martë, 2 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

Hedhet shorti për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e zgjedhjeve të 14 shkurtit

LV-ja 127, LDK-ja 132,
PDK-ja 134, AAK-ja 135
dhe Nisma 121 | FAQE 3

NISMA	NISMA Socialdemokrate	121
V	Lëvizja Vetëvendosje	127
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës	132
PDK	Partia Demokratike e Kosovës	134
AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	135

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ME CEREMONI SOLEMNE, KOSOVA DHE IZRAELI KANË FORMALIZUAR RAPORTET NDËRSHTETËRORE | FAQE 4-5

KOSOVA DHE IZRAELI VENDOSIN MARRËDHËNIE DIPLOMATIKE

E TË JASHTME DHE DIASPORËS
STRANIH POSLOVA I DIJASPORE
EIGN AFFÄRENS UND DIASPORA



Republika e Kosovës dhe Izraeli të hënë kanë bërë historinë. Në një ceremoni solemne virtuale, ministrat e jashtëm të të dy vendeve kanë firmosur dokumentin për vendosjen e marrëdhënieve

diplomatike. Ky moment është vlerësuar historik nga të dyja palët. Ministri i Punëve të Jashtme i Izraelit, Gabriel Ashkenazi, ka thënë se popujt e të dy vendeve kanë marrëdhënie të ngroha dhe

miqësore. Ndërsa zyrtarët më të lartë shtetërorë të Kosovës kanë vlerësuar se njohja nga Izraeli dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike me këtë vend e forcon pozicionin ndërkombëtar të Kosovës

SOT SHËNOHET 31-VJETORI I LËVIZJES SË PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË: 1990-1991

LËVIZJA QË I PAJTOI DHE BASHKOI SHQIPTARËT PËR LUFTË



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



PROKURORIA NË HAGË KËRKON QË GJYKIMI NDAJ SALIH MUSTAFËS TË NISË NË MARS F.5

SPECIALIZANTËT ME VETËFINANCIM DO TË PAGUHEN PËRMES SUBVENCIONEVE GJATË SHKOLLIMIT SPECIALISTIK F.7

NË 24 ORËT E FUNDIT, 184 TË SHËRUAR DHE 282 RASTE ME COVID NË KOSOVË F.3

EKONOMI

PANDEMIA KA RRRITUR PABARAZITË EKONOMIKE NË BOTË F.8

Shkruan: Burim BREZNICA



ATK-ja: PAGUAJ TATIMIN BAZË DHE INTERESIN, PËRFITO NGA SHLYERJA E NDËSHKIMEVE F.9



SPORT

DRENICA, KLUBI MË AKTIV NË AFATIN E JANARIT F.12

Trumpi formon ekip të ri ligjor për gjyqin kundër tij

WASHINGTON, 1 SHKURT - Ish-presidenti amerikan Donald Trump ka njoftuar se do të ketë ekip të ri ligjor në gjyqin kundër tij në Senat, pak para se të përfundojë afati për dorëzim të përgjigjes së tij ndaj padisë.

Dy avokatë, të cilët do ta përfaqësojnë Trumpin, David Schoen, komentator televiziv i çështjeve ligjore dhe Bruce Castor, ish-avokat i distriktit të Pensilvanisë, kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre, pasi të gjithë pesë anëtarët e ekipit fillestar të ish-presidentit është raportuar se kanë ndarë rrugët me Trumpin për shkak të dallimeve në strategji. David Schoen dhe Bruce

Castor janë "avokatë gjyqi shumë të respektuar" me përvojë në fushatën penale dhe atë të mbrojtjes, bazuar në një deklaratë të Trumpit. Gjyqi kundër Trumpit pritet të nisë më 9 shkurt.

Castor është përballur me kritika të ashpra për vendimin e tij për të mos dënuar Bill Cosby në rastin për krime seksuale, ndërkohë që Schoen ka përfaqësuar aleatin e Trumpit, Roger Stone, dhe ka thënë se ka qenë në negociata me ekipin ligjor të financierit Jeffrey Epstein më 2019, para se ai të kryente vetëvrasje në burg.

Epstein supozohej se ka trafikuar vajza të mitura për



marrëdhënie seksuale. Të dy avokatët kanë thënë të dielën se janë të nderuar që

kanë marrë këtë pozitë në gjyqin ndaj Trumpit. "Fuqia e kushtetutës tonë pritet të

testohet sikurse kurrë më parë në histori. Është e fortë dhe e fuqishme. Një dokument që është shkruar për vite dhe i cili do të triumfojë kundrejt bazave partiake sërish dhe gjithmonë", ka thënë Castor.


Gjyqi kundër ish-presidentit amerikan për "nxitje të kryengritjes" që ka të bëjë me sulmin ndaj Kongresit nga ana e mbështetësve të tij, ka nxitur mospajtime në mes të besnikëve të Trumpit që dominojnë Partinë Republikane dhe krahut të moderuar.

Megjithatë, Trumpi pritet t'i ikë dënimit për shkak të mbështetjes së partisë së tij në Senat.

Hungarezët protestojnë kundër masave kufizuese

BUDAPEST, 1 SHKURT - Qindra persona kanë protestuar në Budapest të Hungarisë kundër masave izoluese që autoritetet kanë vendosur me qëllim që ta frenojnë përhapjen e mëtejme të koronavirusit.

Protestuesit kishin vendosur maska në fytyrë, por nuk respektuan rregullat që ndalojnë tubimet publike. Policia ka kërkuar dokumentet e identifikimit të pjesëmarrësve në këtë protestë. Ndërkaq, pronarët e të paktën 100 restoranteve në kryeqytetin hungarez janë zotuar se do t'i rihapin



bizneset e tyre nga 1 shkurti, pavarësisht se qeveria i ka paralajmëruar se ata mund të

përballen me gjoba deri në 17 000 dollarë nëse bëjnë një gjë të tillë. Sipas masave aktuale,

në Hungari ka orë policore gjatë natës. Po në këtë shtet janë të mbyllura shkollat e mesme si dhe të gjitha restorantet dhe kafenet. Këto biznese të gastronomisë lejohet të punojnë vetëm me porosi. "Mjaft më me shkatërrimin e bizneseve", thanë organizatorët e protestës në një postim në "Facebook".

Qeveria e kryeministrit hungarez Viktor Orban tha se do ta nisë lehtësimin e masave nëse bie numri i infeksioneve apo nëse një numër i madh i hungarezëve vaksinohen

kundër koronavirusit.

Më 29 janar Orban deklaroi për radion shtetërore se "njerëzit mund të vdesin nëse ne nuk i mbajmë në fuqi për disa javë të tjera masat kufizuese". Javën e kaluar Hungaria u bë shteti i parë i Bashkimit Evropian që arriti marrëveshje për blerjen e vaksinës ruse Sputnik-V dhe të vaksinës së kompanisë kineze Sinopharm.

Hungaria, që ka popullsi prej rreth dhjetë milionë banorësh, që prej fillimit të pandemisë ka raportuar për 367 586 raste me Covid-19, përfshirë edhe 12 524 viktima.

Dy milionë australianë në izolim pas një infektimi me Covid

PERTH, 1 SHKURT - Rreth dy milionë australianë kanë nisur ditën e tyre të parë të izolimit të ashpër, pas zbulimit të një rasti të infektimit në Perth, kryeqytetin e Australisë Perëndimore. Autoritetet kanë marrë vendim për izolim pesëditor, pasi një rojë e sigurimit në një hotel, që ka dërguar njerëzit në karantinë kur janë kthyer nga vendet jashtë shtetit, ka rënë në kontakt me virusin.

Qeveria ka thënë se 66 persona besohet se kanë qenë në kontakt të ngushtë me rojën dhe asnjëri prej atyre që janë testuar nuk janë infektuar. "Në total 13 kontakte të ngushta tani kanë rezultuar negative dhe 11 prej tyre janë dërguar në karantinë në hotele si masë tjetër e mbrojtjes", ka thënë kryeministri i shtetit të Australisë Perëndimore, Mark McGowan. Sipas tij, testet e

pjesës tjetër të kontakteve do të kompletohen të hënën.

Australia ka arritur ta ndalë hovin e pandemisë, duke e kufizuar atë në 29 000 raste dhe 909 vdekje përmes masave të ashpra sikurse ato të Perthit, dhe me kontroll të shtuara kufitare. Fushata e vaksinimit pritet të nisë këtë muaj, e cila, sipas kryeministrit australian, Scott Morrison, do të kushtojë të paktën 6.3 miliardë dollarë australianë.



Pas puçit, liderja e Mianmarit bën thirrje për protesta



YANGON, 1 SHKURT - Ushtria e Mianmarit ka vënë nën kontroll shtetin, pasi ka ndaluar lideren de fakto, Aung San Suu Kyi, dhe politikanë të tjerë, në orët e para të 1 shkurtit.

Televizioni ushtarak ka thënë se gjendja e jashtëzakonshme do të shpallet për një vit dhe fuqia do të transferohet. Puçi

ka ardhur pas tensioneve në rritje në mes të qeverisë civile dhe ushtrisë për shkak të zgjedhjeve kontestuese. Vetë liderja Suu Kyi u ka bërë thirrje mbështetësve që "të mos pranojnë këtë" dhe "të protestojnë kundër puçit". Në një letër të shkruar teksa është përgatitur për ndalimin e saj, Suu Kyi ka thënë se veprimet e

ushtrisë e kanë kthyer shtetin mbrapa nën diktaturë.

Mianmari, i njohur edhe si Burma, është udhëhequr nga ushtria derisa kanë nisur reformat demokratike më 2011. Ushtria ka njoftuar të hënën se do t'ia dorëzojë pushtetin kryekomandantit Min Aung Hlaing për shkak të "mashtrimeve zgjedhore".

Është hedhur shorti për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021

LV-ja 127, LDK-ja 132, PDK-ja 134, AAK-ja 135 dhe Nisma 121

	NISMA Socialdemokrate	121
	Lëvizja Vetëvendosje	127
	Lidhja Demokratike e Kosovës	132
	Partia Demokratike e Kosovës	134
	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	135

politike kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe u bëri thirrje që ta respektojnë ligjin.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pranuar një raport jopërfundimtar nga shërbimi votues lidhur me periudhën e aplikimit për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës. Sipas zëdhënësit të KQZ-së, Valmir Elezi, numri i përgjithshëm i aplikacioneve të cilat janë futur në sistem ka qenë 175 273 aplikacione.

"Pas verifikimeve janë larguar 43 801 aplikacione si dublikate, të cilat janë dërguar nga aplikues më shumë se një herë në tre e-mailat e shërbimit votues gjatë periudhës së aplikimit. Pra, në bazë të të dhënave jopërfundimtare, KQZ-ja ka pranuar nga 13 deri më 21 janar rreth 131 500 aplikacione për regjistrim si votues jashtë Kosovës. Vetëm 33 aplikacione janë pranuar përmes fahut postar dhe 195 të tjera përmes faksit të KQZ-së, ndërsa pjesa më e madhe e tyre, 131 244 aplikacione, janë pranuar përmes e-mailave të shërbimit votues", ka thënë Elezi.

Ai ka shtuar se pas vlerësimit të aplikacioneve janë aprovuar 101 839 aplikacione për regjistrim, ndërsa janë refuzuar 29 633 aplikacione. "Në 29 100 raste aplikuesit janë refuzuar për shkak se nuk e kanë dëshmuar identitetin ose kriteret e zotësisë juridike apo nuk kanë nënshkruar aplikacionin për regjistrim. Në 65 raste të tjera aplikuesit janë refuzuar për shkak se në ditën e zgjedhjeve nuk arrijnë moshën 18 vjeç. Sa për sqarim, ky nuk është një raport përfundimtar, sepse shërbimi votues ende është duke bërë kontrollimin e dokumenteve të shtypura dhe krahasimin e tyre", ka deklaruar Elezi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë tërheqjen e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021. Tërheqja e numrave për renditje në fletëvotim është bërë nga përfaqësues të subjekteve politike. Lëvizja Vetëvendosje do të garojë me numrin 127, LDK-ja me numrin 132, PDK-ja me numrin 134, AAK-ja me numrin 135 dhe Nisma me numrin 121

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të hënën ka bërë tërheqjen e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021. Pas tërheqjes së shortit, Lëvizja Vetëvendosje (LV) do ta ketë numrin 127 në fletëvotim. Lidhja Demokratike

e Kosovës (LDK) do ta ketë numrin 132. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) do ta ketë numrin 134. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) do ta mbajë numrin 135. Nisma Socialdemokrate do ta ketë numrin 121 dhe Lista Serbe do ta ketë numrin 119.

Ndërkaq, partitë e tjera mbajnë numrat: Partia Rome e Bashkuar e Kosovës 117, Lëvizja Përparimtare e Romëve të

Kosovës 123, Lëvizja për Bashkëveprim 116, Koalicioni VAKAT 113, Subjekti Fjala 138, Nova Demokratska Stranka 131, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës 111, Srpski Demokratski Savez 118, Roman Iniciativa 124, Lista Serbe 119, Partia e Ashkalinjve për Integritet 130 etj. Kryetarja e KQZ-së, Valdeta Daka, pas tërheqjes së shortit, ka thënë se institucioni që drejton është i përkushtuar të sigurojë

një proces zgjedhor mbi bazën e Kushtetutës dhe ligjeve. "Mes sfidave të shumta, KQZ-ja është duke u përkushtuar maksimalisht për përmbushjen e detyrave që dalin nga Kushtetua dhe Ligji për Zgjedhjet. Dua t'i garantoj të gjithë se KQZ-ja mbetet e përkushtuar për organizimin e zgjedhjeve sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi", ka thënë Daka. Ajo ka shtuar se subjektet

Në 24 orët e fundit, 184 të shëruar dhe 282 raste me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 1 SHKURT (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 192 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 282 raste pozitive me Covid. Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të të vdekurve si

pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komuna: Gjilan një rast (72 vjeç), Lipjan një rast (71 vjeç), Prishtinë një rast (87 vjeç), Prizren një rast (84 vjeç) dhe Shtime një rast (76 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 60 500 raste nga 235 724 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 503 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 184 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 52 621 raste, kurse



numri i rasteve aktive është 6 376. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 96 raste, Prizren 48 raste, Podujevë 19 raste, Ferizaj 16 raste, Fushë-Kosovë 13 raste, Pejë 13 raste, Drenas 10 raste, Mitrovicë 10 raste, Rahovec 10 raste, Gjakovë 8 raste, Lipjan 7 raste, Skenderaj 6 raste, Gjilan 5 raste, Suharekë 5 raste, Klinë 4 raste, Viti 3 raste, Kamenicë 2 raste, Kaçanik 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Malishevë, Ranillug, Shtime dhe Vushtrri 1 rast.



ME CEREMONI SOLEMNE, KOSOVA DHE IZRAELI KANË FORMALIZUAR RAPORTET NDËRSHTETËRORE

Kosova dhe Izraeli vendosin marrëdhënie diplomatike

Republika e Kosovës dhe Izraeli të hënën kanë bërë historinë. Në një ceremoni solemne virtuale, ministrat e jashtëm të të dy vendeve kanë firmosur dokumentin për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Ky moment është vlerësuar historik nga të dyja palët. Ministri i Punëve të Jashtme i Izraelit, Gabriel Ashkenazi, ka thënë se popujt e të dy vendeve kanë marrëdhënie të ngroha dhe miqësore. Ndërsa zyrtarët më të lartë shtetërorë të Kosovës kanë vlerësuar se njohja nga Izraeli dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike me këtë vend e forcon pozicionin ndërkombëtar të Kosovës

siç e thashë edhe më herët, historik dhe i jashtëzakonshëm, i cili jo vetëm që e forcon subjektivitetin tonë ndërkombëtar, por edhe rrezon secilin argument për vendet mosnjohëse për të vazhduar me mosnjohjen e tyre ndaj pavarësisë së Kosovës”, ka thënë ajo, duke shtuar se me njohjen e Izraelit ndalet edhe fushata agresive e Serbisë për çnjohje të pavarësisë së Kosovë. “Me aktin e sotëm të vendosjes së këtyre marrëdhënieve diplomatike dhe konkretizimit të kësaj njohjeje Kosova thyen edhe zinxhirin e fushatës agresive të Serbisë për çnjohjen e Republikës së Kosovës dhe po krijojmë një

teren dhe horizont të ri për njohjen universale”, ka thënë ajo, duke falënderuar Shtetet e Bashkuara për ndihmën që i ka dhënë Izraelit për të vendosur marrëdhënie diplomatike.

Në dokumentin e nënshkruar shtetet zotohen të bashkëpunojnë në shumë sfera. “Të udhëhequr nga vullneti i përbashkët për t'i promovuar dhe forcuar lidhjet miqësore, si dhe për ta zgjeruar horizontet e bashkëpunimit mes dy vendeve dhe bazuar në parimet universale të ligjit ndërkombëtar; duke riafirmuar përkushtimin e përbashkët për ta forcuar bashkëpunimin e frytshëm në sferën politike, ekonomike, të tregtisë, teknike e kulturore dhe në sfera të tjera të interesit të përbashkët (Kosova dhe Izraeli) kanë vendosur që të themelojnë marrëdhënie diplomatike në nivel ambasadorësh”, thuhet në dokumentin të cilin e nënshkruan kryediplomatët e Kosovës dhe të Izraelit.

Dokumenti i nënshkruar për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike u nënshkrua në katër kopje: në gjuhën shqipe, angleze, hebreje dhe serbe. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin, Matthew Palmer.

Në dokument, po ashtu, thuhet se aspektet teknike të këtij vendimi, përfshirë edhe akreditimin e ambasadorëve respektivë, “do të jenë objekt i

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 1 SHKURT - Republika e Kosovës të hënën ka lidhur raporte diplomatike me shtetin e Izraelit. Vendosja e marrëdhënieve është bërë në një ceremoni solemne virtuale, ku ministrat e jashtëm të të dy vendeve kanë nënshkruar dokumentin në të cilin thuhet se të dy shtetet vendosin marrëdhënie diplomatike, me qëllim që ta rrisin bashkëpunimin në shumë sfera.

Ministri i Punëve të Jashtme i Izraelit, Gabriel Ashkenazi, ka thënë se ky moment është kritik për të dy vendet. “Sot po bëjmë histori. Po vendosim marrëdhënie diplomatike ndërmjet Izraelit dhe Kosovës, një moment që është pritur nga shumëkush. Kjo është hera e parë që marrëdhëniet diplomatike po vendosen përmes Zoom-it. Sot ne kemi mundësi që ta rrisim

bashkëpunimin me popullin e Kosovës, me të cilin kemi marrëdhënie të ngrohta dhe miqësore”, ka thënë ai. Ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, në një konferencë për media, pas nënshkrimit të

konkretizimit të marrëdhënieve diplomatike me Izraelin, ka ritheksuar se kjo është një ditë historike për Kosovën. “Kosova sot po çan nyjat e bllokadës me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Izraelin - një moment ky,





diskutimeve të mëtejme përmes kanaleve normale diplomatike”.

Ambasadorja e Kosovës në Izrael do të jetë Ines Demiri, e cila më 2020 ishte emëruar e ngarkuar me punë në po këtë shtet.

Gjatë ceremonisë, në mënyrë simbolike u zbulua edhe pllaka që do të vendoset pranë Ambasadës së Kosovës në Jerusalem.

Dy ministrët, po ashtu, nënshkruan memorandum për konsultime politike dhe memorandum për bashkëpunim zhvillimor. Që të dy këto memorandume ishin të shkruara në gjuhën angleze.

Kosova mirëpret vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Izraelin

Ushtruesja e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, ka vlerësuar se lidhjet e këtyre dy popujve historikisht kanë qenë të forta. “Marrëdhëniet ndërmjet dy popujve tanë kanë qenë historikisht të fuqishme e të bazuara në solidaritet dhe miqësi. Akti i lidhjes së marrëdhënieve diplomatike hap rrugën për thellimin e bashkëpunimit dypalësh ndërinstitucional si dhe në fusha të tjera të interesit të

përbashkët”, ka vlerësuar Osmani përmes një deklarate për media.

Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka thënë se me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Izraelin është thyer bllokada e njohjeve për Kosovën. “Kemi hapur kapitull të ri të fuqizimit të shtetësisë së Kosovës. Me marrëveshjen e sotme që derivon nga marrëveshja e 4 shtatorit, kemi thyer bllokadën e njohjeve për Kosovën. Me nënshkrimin dhe lidhjen e marrëdhënieve mes dy shteteve tona, shteti i Kosovës konsolidohet tutje në arenën ndërkombëtare falë

mbështetjes që kemi pasur nga ShBA-ja. Marrëveshja e sotme është argument se marrëveshja e 4 shtatorit ka qenë e mirë dhe i nxjerr gabim ata që kritikuan këtë marrëveshje duke kritikuar edhe njohjen që ka ndodhur nga Izraeli në Shtëpinë e Bardhë”, ka deklaruar Hoti.

Kurse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, e ka vlerësuar akt historik vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në mes të Republikës së Kosovës dhe Izraelit. “Akti historik i njohjes së Kosovës nga Izraeli forcon pozitën e Kosovës dhe diplomacisë së saj në arenën ndërkombëtare. Subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës po konsolidohet dhe fuqizohet. Ky akt shënon një kapitull të ri në marrëdhëniet dypalëshe dhe forcimin e lidhjes mes dy popujve”, ka shkruar ai në profilin e vet në “Facebook”, duke falënderuar ShBA-në për kontributin e dhënë në këtë njohje. “Jam shumë i lumtur me këtë ngjarje, e cila ndodh në kohën kur vendi ynë ndodhet në udhëkryq. Falënderues për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ndërmjetësimin e tyre për këtë njohje kaq të rëndësishme. Kjo është edhe një dëshmi e

fortë se marrëdhëniet me aleatin tonë, ShBA-në, janë të një rëndësie të veçantë dhe strategjike dhe si Kosovë vazhdimisht do t'i forcojmë ato. Kjo do të jetë edhe një prej detyrave të mia parësore si president i ardhshëm i vendit. Falënderim i veçantë për popullin dhe shtetin e Izraelit!”, ka shkruar Haradinaj.

Vendosja e raporteve diplomatike është vlerësuar lart edhe nga njohësit e rrethanave politike.

Analisti Ilir Ibrahimimi ka bërë me dije se vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Izraelin është një nga arritjet më të mëdha të diplomacisë së Kosovës në vitet e fundit. “Vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Izraelin është një nga arritjet më të mëdha të diplomacisë së Kosovës në vitet e fundit. Kjo duhet të përshëndetet dhe përqafohet nga të gjithë, pa dallim. Në këto momente të dallimeve të mëdha ndërpartiake, ky moment mund të shfrytëzohet për një relaksim të gjuhës dhe akuzave të ndërsjella dhe t'u gëzohemi sukseseve të përbashkëta”, ka thënë Ibrahimimi.



Prokuroria në Hagë kërkon që gjykimi ndaj Salih Mustafës të nisë në mars

HAGË, 1 SHKURT - Zyra e Prokurorit të Specializuar kërkoi që gjykimi ndaj ish-epropolit të UÇK-së, Salih Mustafa, të nisë në muajin mars, por pala mbrojtëse tha se gjykimi duhet të nisë në korrik ose pasi t'i kenë kryer hetimet. “Dikur në korrik, në atë periudhë kohore, ndoshta nuk do t'i kemi përfunduar të gjitha hetimet tona, por kjo është koha e përafërt që mund të jap”, ka thënë avokati i Mustafës, Julius Von Bone.

Në konferencën statusore apo për ecurinë e çështjes, Prokuroria tha se do të jetë në gjendje t'i dërgojë të gjitha materialet e dosjes hetimore deri më 15 shkurt. Por, mbrojtja tha se do t'i duhet kohë deri në gusht, që t'i kryejë hetimet, në mënyrë që të përgatitet për gjykim.

Zëvendësi i Prokurorit të Specializuar, Alex Whiting, tha se koha që po kërkon mbrojtja është e papranueshme. Ai tha se mbrojtja ka pasur kohë të

mjaftueshme që ta përgatisë çështjen e saj.

Avokati i Mustafës, holandezi Julius Von Bone, tha se mbrojtja parashikon që për dy muaj të intervistojë dy dëshmitarë që, sipas tij, do të mbështesnin një alibi për Mustafën, që mbrojtja dëshiron ta paraqesë.

Mbrojtja tha se ka në agjendë që të intervistojë edhe dëshmitarë të tjerë dhe të analizojë raporte të cilat do t'i ndihmonin ta ndërtonin rastin e tyre. Por, prokuroria tha se “objekti i çështjes është shumë i qartë dhe nuk ka nevojë për hetime të zgjeruara”, thanë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Gjatë seancës, Prokuroria u zotua se do t'ia dorëzojë palës mbrojtëse materialet e nxjerra, duke përfshirë edhe ato shfajësuese.

Prokuroria përmendi se këtyre materialeve mund t'u shtohet edhe një dëshmitar, i cili është intervistuar më herët nga ta, por që prokurorët ende janë duke



verifikuar të dhënat. Në këtë seancë nuk mori pjesë Salih Mustafa, për të cilën ai i ka njoftuar me shkrim Dhomat e Specializuara.

Von Bone foli edhe për materialet që ka pranuar nga Prokuroria dhe tha se nuk ka pasur ndonjë vështirësi, përveçse disa materiale nuk janë të përkthyer në shqip. “E vetmja vështirësi është se disa nga

materialet e nxjerra janë në gjuhën angleze, disa nga deklaratat nuk janë përkthyer në shqip. Kjo është e vetmja vështirësi që kemi”, tha Von Bone.

Gjatë seancës, Von Bone dy herë kërkoi nga gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, që seanca të mbyllet për media, ku palët të diskutojnë lidhur me provat të cilat mund të

përmbajnë informacione të mbrojtura.

Salih Mustafa akuzohet nga Dhomat e Specializuara për krime lufte. Aktakuza ndaj tij ka katër pika: ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme.

Më 28 tetor të vitit 2020, Mustafa u deklarua i pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës. Ish-epropri i UÇK-së, Salih Mustafa, u arrestua më 24 shtator në shtëpinë e tij që gjendet në periferi të Prishtinës, pasi i ishte konfirmuar aktakuza për krime lufte.


Prokuroria e Specializuar në Hagë heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 e deri në dhjetor të vitit 2000. Këto krime të pretenduara përmenden në një raport të Këshillit të Evropës të vitit 2011, autor i të cilit është senatori zviceran Dick Marty.

Sot shënohet 31-vjetori i Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1991

Lëvizja që i pajtoi dhe bashkoi shqiptarët për luftë

PRISHTINË, 1 SHKURT (ER) - Sot, më 2 shkurt, bëhen 31 vjet të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë, 1990-1991. Nismëtarët e pajtimit të gjaqeve në Kosovë ishin Myrvete Dreshaj, Have Shala, Adem Grabovci, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj. Të gjithë studentë dhe ish të burgosur politikë. Shtrirja e dorës së pajtimit të parë në Kosovë, e arritur nga kjo Lëvizje, pas 14 vjetësh hasmëri, është ajo në mes të Fazli Buqollit dhe Idriz Buqollit, më 10 shkurt 1990, në fshatin Raushiq të Pejës. Kontribut të fuqishëm për arritjen e këtij pajtimi ka dhënë edhe heroi Xhemajl Fetahaj.

Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve u përhap shpejt dhe mori përmasa gjithëpopullore ku, pas ftesës së nismëtarëve, u inkuadruan Anton Çetta dhe shumë profesorë të tjerë të UP-së. Shtrirja e pajtimit të gjaqeve mori hov edhe në Tetovë, Shkup, Gostivar, Luginë të Preshevës etj.



Me qëllim të koordinimit të veprimtarisë së saj, Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë, gjatë periudhës njëvjeçare të

funkcionimit, 1990-1991, ka mbajtur tri Kuvende: Kuvendi I, 19 maj 1990 në Strellc të Deçanit; Kuvendi II, 18 nëntor 1990 në Osekë Hylë të Gjakovës, Kuvendi III, 17 maj 1992 në Prishtinë.

me ngrehë gishtin e kimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit".

Numri i pajtimeve të arritura brenda një viti, 1990-1991, të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve, shkoj në 2 511. Prej tyre, 1 169

Botohet libri "Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1991"

Pas një pune disavjeçare, para një viti, më 1 shkurt 2020, është botuar libri monografik "Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1991", i autorit Lulëzim Etemaj. Libri është ilustruar edhe me letra, me fotografi, me procesverbale, me shënime, me përjetime. Të gjitha këto bashkë janë bërë publike për herë të parë pas 30 vjetësh.

Libri "Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1991" është shpërndarë tashmë në libraritë më të mëdha të Kosovës. Të interesuarit librin mund ta gjejnë në këto qytete: Në Prishtinë në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në librarinë "Dukagjini", "Artini"

Tubimet masive për faljen e gjaqeve

Më 15 prill 1990 është mbajtur tubimi për faljen e gjaqeve në Novosellë të Gjakovës dhe Zllakuqan, në ditën e festës së Pashkëve. Aty u falën 16 gjaqe, plagë e ngatërresa. Ndërkaq më 26 prill 1990 është mbajtur një tubim edhe në Bubavec të Malishevës, ku u falën 37 gjaqe, shumë plagë dhe ngatërresa. Më 1 maj 1990 është mbajtur tubimi për faljen e gjaqeve te Verrat e Llukës, ku ndodhën 106 pajtime: 62 gjaqe, 25 plagë dhe 19 ngatërresa. Në këtë tubim pajtues morën pjesë 500 000 pjesëmarrës. Më 28 korrik 1990 u mbajt edhe një tubim për faljen e gjaqeve në Çegran, në "Rudinën e Pajtimit", bri Malit të Thatë, ku u falën 3 gjaqe dhe 6 ngatërresa. Aty arritën të tuboheshin 50 mijë veta. Shumica e tubimeve të tilla të mëdha hapeshin me thirrjen - kushtrim të heroit Adem Demaçi: "Jo atyne që janë trima



janë gjaqe; 477 plagë, ndërsa 865 është numri i ngatërresave. Të gjitha gjaqet, plagët dhe ngatërresat u falën nga familjet e dëmtuara pa asnjë kusht a kompensim, në emër të rinisë, të Kosovës, flamurit kombëtar dhe gjakut të dëshmorëve të rinj që po shtoheshin çdo ditë; në emër të të burgosurve politikë që po kalbeshin nëpër burgjet e Jugosllavisë.

dhe "Buzuku"; në Pejë në librarinë "Dukagjini"; në Ferizaj në librarinë "Rilindja"; në Istog në librarinë "Smartpoint" dhe "Meshari"; në Gjakovë në librarinë "Tomorri"; në Prizren në librarinë "Altera". Mërgimtarët, librin mund ta gjejnë te "Libraria shqiptare në diasporë", me seli në Zvicër.



Specializantët me vetëfinancim do të paguhen përmes subvencioneve gjatë shkollimit specialistik

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se, përveç lirimit nga pagesa prej 500 eurosh për vitin e shkollimit specialistik, Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria e Kosovës do të mundësojnë që këta specializantë të paguhen përmes subvencioneve gjatë shkollimit të tyre specialistik, me qëllim që të njëjtët ta përballojnë më lehtë krejt procesin e specializimit deri në përfundim të programit

të mbështetjes dhe stimulimit për të gjithë specializantët që kanë nënshkruar kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë për shkollimin specialistik, kategoria 'specializanti me vetëfinancim', që janë 520 dhe për të mundësuar shkollim specialistik cilësor dhe adekuat, sipas planit dhe programit specialistik", ka thënë ministri Zemaj.

qenë falënderues për këtë mundësi të madhe të cilën atyre ua ka dhënë Ministria e Shëndetësisë dhe qeveria, duke u bazuar në përkushtimin tonë që të mos lëmë mjekë pa iu dhënë mundësia që të specializojë dhe të mos lëmë mjekë të specializuar pa punë. Ministria e Shëndetësisë, me mbështetjen e Qeverisë së Republikës, gjatë këtij mandati ka bërë një hap të jashtëzakonshëm duke ndarë 1500 specializime, pas një procesi të bllokuar pa asnjë arsye për disa vjet. Kjo situatë është zhblokuar dhe ajo që na mbetet obligim është t'i përkrahim edhe më tej të rinjtë tanë, profesionistët tanë për arritjen e shkathtësive profesionale që të jenë me dijet e tyre ekuivalente me kolegët e tyre kudo në botë dhe kësaj t'i kontribuojmë procesit që mjekët t'i aftësojmë dhe t'i kemi në sistemin tonë shëndetësor dhe të ketë sa më pak arsye që dikush ta braktisë vendin", ka

deklaruar Zemaj.

Duke iu uruar për këtë hap specializantëve të ri, ministri Zemaj ka thënë se shpreh përkushtimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për t'i dhënë gjithmonë prioritet kategorisë së profesionistëve shëndetësorë, të cilët me punën e tyre, në veçanti në menaxhimin e pandemisë Covid-19, po tregojnë vlerat e larta profesionale dhe humane. Specializanti Nol Smajli, në emër të grupit të specializantëve me vetëfinancim, falënderoi ministrin Zemaj, BQShS-në dhe Qeverinë e Kosovës për qasjen bashkëpunuese me qëllim që kësaj kategorie të mjekëve t'i mundësohet mbështetja financiare për shkollim specialistik dhe vetëshkollimi specialistik. "Bashkëpunimi që kemi hasur në bën që të motivohemi për ta kryer shkollimin specialistik dhe për të kontribuar në vendin tonë", ka thënë ai.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 SHKURT - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije të hënën se janë liruar nga pagesa e shkollimit specialistik për çdo vit, të gjithë specializantët me vetëfinancim me kërkesë të institucioneve shëndetësore private dhe publiko-private dhe nga vetë specializantët të cilët kanë nënshkruar kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë. Në një konferencë për media, bashkë me një grup të

specializantëve dhe kryetarin e Bordit Qendror për Shkollim Specialistik, dr. Labinot Shanini, ministri Zemaj ka thënë se, përveç lirimit nga pagesa prej 500 eurosh për vitin e shkollimit specialistik, Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria e Kosovës do të mundësojnë që këta specializantë të paguhen përmes subvencioneve gjatë shkollimit të tyre specialistik, me qëllim që të njëjtët ta përballojnë më lehtë krejt procesin e specializimit deri në përfundim të programit. "Ky vendim është marrë me qëllim

Ai, gjithashtu, ka thënë se vendimi është marrë për t'i mbështetur financiarisht specializantët dhe familjet e tyre, duke ua dhënë mundësimin e shkollimit pa pasur nevojë për pagesë shtesë dhe për të krijuar siguri dhe stabilitet të specializantit në shkollim.

Zemaj ka theksuar se besojnë se ky është një vendim shumë i rëndësishëm për specializantët që ishin me vetëfinancim dhe për familjet e tyre. "Kështu që nga tani besojmë se fokusi i tyre do të jetë për arritjen e shkathtësive profesionale, duke



Hoti kërkon masa urgjente ndaj zyrtarëve policorë që keqpërdorin detyrën



PRISHTINË, 1 SHKURT (ER) - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të hënën në takim drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti dhe kryeshëfimin ekzekutiv të Inspektoratit të Policisë së Kosovës, Kushtrim Hodaj. Kryeministri Hoti ka kërkuar

nga Mehmeti dhe Hodaj që menjëherë t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme ndaj çdo zyrtari policor i cili keqpërdor detyrën, duke theksuar se këto sjellje janë të papranueshme. Kryeministri Hoti kërkoi nga Inspektorati Policor t'i trajtojë me shumë përkushtim të gjitha ankesat e qytetarëve që vijnë në

adresë të policisë, të jenë këmbëngulës dhe të pakompromis për respektimin e etikës dhe sjelljes profesionale të policisë. Kryeministri Hoti theksoi se nuk duhet lejuar që rastet e izoluara ta dëmtojnë imazhin e policisë së Kosovës, institucionit më të besuar nga qytetarët për vite me radhë.

ATK-ja: Paguaj tatimin bazë dhe interesin, përfito nga shlyerja e ndëshkimeve

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se do të hiqen ndëshkimet për të gjithë tatimpaguesit të cilët kryejnë pagesën e plotë të tatimit bazë (kryegjësë) dhe interesit. Sipas ATK-së, kjo mundësi vjen për shkak të lehtësimit të ushtrimit të aktivitetit ekonomik të të gjithë tatimpaguesve, si pasojë e gjendjes së vështirësuar ekonomike të krijuar nga pandemia Covid-19



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 SHKURT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) u ka bërë thirrje tatimpaguesve borxhlinj që t'i shfrytëzojnë mundësitë e lehtësimeve tatimore. "Me qëllim të zbatimit të vendimit nr. 04/60 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, datë 27.01.2021, për lehtësimin e ushtrimit të aktivitetit ekonomik të të gjithë tatimpaguesve, si pasojë e gjendjes së vështirësuar ekonomike të krijuar nga

pandemia Covid-19, Administrata Tatimore e Kosovës njofton se hiqen ndëshkimet për të gjithë tatimpaguesit të cilët kryejnë pagesën e plotë të tatimit bazë (kryegjësë) dhe interesit", është theksuar në njoftimin e ATK-së.

Sipas këtij njoftimi, të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të cilët kanë obligime tatimore të papaguara ndaj ATK-së, për të gjitha periudhat dhe llojet e tatimeve/kontributeve, mund të përfitojnë nga falja e ndëshkimeve, me kusht që të

njëjtët ta kryejnë pagesën e plotë të tatimit bazë (kryegjësë) dhe interesit deri më 30 qershor 2021. Pra, heqja e ndëshkimeve bëhet për të gjithë tatimpaguesit, nëse: Tatimpaguesit bëjnë pagesën e njëhershme të tatimit bazë (kryegjësë) dhe interesit; Tatimpaguesit bëjnë marrëveshje me ATK-në për pagesë me këste;

Tatimpaguesit janë në marrëveshje me ATK-në dhe paguajnë tatimin bazë (kryegjësë) dhe interesin. "Vetëm tatimpaguesit të cilët shfrytëzojnë këtë mundësi dhe përmbushin detyrimin e kërkuar brenda periudhës ligjore deri më 30 qershor 2021 do të përfitojnë nga falja e ndëshkimeve. Heqja e

ndëshkimeve për tatimpaguesit të cilët paguajnë tatimin bazë (kryegjësë) dhe interesin, për të gjitha periudhat dhe llojet e tatimeve/kontributeve, do të bëhet në mënyrë automatike nga ATK-ja, pra tatimpaguesi nuk obligohet të aplikojë për heqje të ndëshkimeve", thuhet në njoftimin e ATK-së.

Hysenaj dhe Shahini diskutuan për lehtësirat tatimore të ATK-së



EPOKA E RE **A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 SHKURT - Zëvendësuesi i drejtorit të përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ekrem Hysenaj, është takuar të hënën me kryetarin e Aleancës Kosovare të Biznesit,

Agim Shahini. Takimi në fjalë është mbajtur me qëllim të diskutimit të vendimit nr. 04/60 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për lehtësimin e ushtrimit të aktivitetit ekonomik të të gjithë tatimpaguesve si pasojë e gjendjes së vështirësuar ekonomike të krijuar nga pandemia Covid-19,

më saktësisht shlyerjen e bllokimit të llogarive bankare për të gjithë tatimpaguesit që kanë obligime tatimore ndaj ATK-së, lirimin e llogarive bankare të bllokuara të të gjithë tatimpaguesve, të cilët, po ashtu, kanë obligime ndaj ATK-së deri më 30.04.2021.

Palët diskutuan edhe për heqjen e

ndëshkimeve për të gjithë tatimpaguesit që kanë detyrime tatimore, nëse kryhet pagesa e tatimit bazë dhe interesit deri më 30.06.2021.

Ky vendim është mirëpritur nga AKB, si dhe në të njëjtën kohë potencuan se do të kërkohet nga të gjithë ata tatimpagues të cilët

kanë obligime ndaj ATK-së, të veprojnë në përputhje me vendimin në fuqi.

Veç këtyre, kryetari Shahini ka vlerësuar punën dhe kontributin e pandërprerë dhe shumë profesional të ATK-së, të dhënë çdoherë, me theks të veçantë në periudhën e pandemisë.

Pandemia ka rritur pabarazitë ekonomike në botë



**Shkruan: Burim
BREZNICA**

Tashmë është bërë një vit prej se pandemia ka goditur shumë vende në botë, kurse disa vende të tjera pak më vonë. Humbja e jetëve të njerëzve është sigurisht fatkeqësia më e madhe për shumë familje dhe shtete që janë goditur dhe deri tani mbi 2 milionë njerëz janë shuar. Pandemia ka goditur në anën tjetër edhe ekonomitë e vendeve, bizneset dhe punësimin dhe në këtë fushë unë do të fokusohem më shumë.

Pandemia ka shkaktuar shumë dëme ekonomike dhe pabarazi mes shteteve dhe njerëzve në botë. Sipas një raportit të fundit nga Organizata britanike OXFAM (konfederatë e rreth 20 organizatave humanitare/OJQ-ve) "The Inequality Virus" apo virusi i pabarazisë, (janar 2021), do të marrë më shumë se 10 vjet derisa pjesa më e varfër e botës do të kthehet në nivelin e njëjtë ekonomik sikurse ishte para fillimit të pandemisë. Në anën tjetër, për 1000 personat më të pasur në botë u deshën rreth

nëntë muaj kohë që t'i kompensojnë humbjet dhe t'i rikthenin pasuritë e tyre. Pandemia ka ndikuar edhe në tregjet e aksioneve si dhe punësimin në mbarë botën. Shumë njerëz kanë humbur vendet e tyre të punës dhe janë bërë më të varfër. Ky raport tregon se për shkak të pandemisë Covid-19 pothuajse në të gjitha vendet e botës është rritur pabarazia ekonomike. Kjo është hera e parë në histori në 100 vjetët e fundit që kur bëhen matje të tilla sipas raportit. Dikush do të thoshte se pabarazia e madhe mes vendeve të pasura dhe të varfra mund të jetë e rrezikshme për të ardhmen.

Varfëria është rritur në shumë vende, kurse të pasurit janë bërë edhe më të pasur

Varfëria, por edhe uria në disa vende, janë rritur në botë si rezultat i pandemisë, gjithnjë sipas raportit të OXFAM. Sipas matjeve deri tani, pandemia ka shkaktuar krizën më të madhe të papunësisë në 90 vjetët e fundit, duke futur deri tani, janar 2021, së paku 200 milionë njerëz në varfëri si rezultat i efekteve ekonomike të pandemisë. Në anën tjetër, 10 njerëzit më të pasur në botë janë bërë edhe më të pasur. Gjatë pandemisë, pasuria e tyre është rritur për rreth 500 miliardë dollarë amerikanë. Ajo

shumë parash do të mjaftonte për ta vaksinuar krejt popullsinë botërore dhe do të mundësonte që jo shumë njerëz të përfundonin në varfëri si rezultat i pandemisë, argumenton raporti në fjalë.

Pabarazitë e shkaktuara nga pandemia

Sipas raportit, vajzat dhe gratë janë goditur më shumë si rezultat i pandemisë për arsye se në nivel global ato janë më të përfaqësuara në grupet e të punësuarve me të ardhura më të ulëta, me kontrata afatshkurta dhe të pasigurta që tani janë keqësuar edhe më tepër. Në raport thuhet se rreth 70 % e personelit shëndetësor dhe atyre që kujdesen për pleqtë, në botë, janë vajza dhe gra.

Në Francë, Indi, Spanjë, si rreziku i infeksionit ashtu edhe vdekshmëria janë më të larta në zonat më të varfra të qyteteve. Në Brazil personat me prejardhje afrikane kanë rreth 40 % rrezik më të lartë të vdesin nga Covid-19 në krahasim me të bardhët, janë disa nga të dhënat e raportit. Në Angli vdekshmëria për shkak të Covid-19 është dyfish më e lartë në zonat e varfra në krahasim me ato të pasura dhe këto të dhëna janë shqetësuese sipas raportit. Kjo do të thotë që pandemia ka rritur ndarjet afatgjata ekonomike, racore dhe gjinore në shumë vende në botë.

Efektet e pandemisë në Kosovë, Shqipëri dhe në rajon

Pandemia ka goditur edhe Kosovë, Shqipëri dhe në vendet e tjera në rajon sikurse në shumicën absolute të vendeve në botë. Humbja e jetëve të njerëzve është për të ardhur keq dhe është një dëm i pakompensueshëm për familjet e tyre në rend të parë, miqtë dhe për shoqëritë në tërësi. Sipas Institutit të Statistikave në Shqipëri, numri i personave që humbën punën për shkak të situatës së krijuar në vend nga pandemia është rreth 50 000 veta, (burimi: www. Euronews.al, 20 janar 2021). Sipas të njëjtit institut, papunësia arrin në rreth 12 %, kurse në Kosovë diku 73 000 veta kanë humbur punën për shkak të pandemisë, deri në qershor 2020, sipas të njëjtit burim. Në Maqedoninë e Veriut kanë humbur punën rreth 53 708 qytetarë deri në tetor 2020 sipas referencës së njëjtë. Të dhënat e sakta është më vështirë të sigurohen në këtë kohë, pastaj një pjesë e njerëzve ndoshta nuk regjistrohen apo raportojnë me kohë. Faktor tjetër mund të jetë ekonomia informale etj. Por, si të dhëna të përafërta tregojnë të njëjtën tendencë si në vendet e tjera në botë, një pjesë kanë humbur të ardhurat e tyre, sigurinë e tyre ekonomike dhe do të jenë më të varfër në krahasim me një vit më parë.

Qeveritë në Kosovë dhe në Shqipëri duhet të ndihmojnë

edhe më shumë se sa kanë deklaruar qytetarët dhe bizneset për t'i përballuar efektet e pandemisë, edhe pse kanë resurse më të kufizuara buxhetore në krahasim me vendet perëndimore. Financimi do të mund të sigurohej nga riorientimi i fondeve dhe buxhetit, nga kreditimi ose huazimet publike, nga kreditimi dhe asistenca ndërkombëtare, nga menaxhimi më i mirë etj.

Në vend të përfundimit

Pandemia ka shfaqur edhe dobësitë e sistemeve politike dhe paaftësinë e sistemeve ekonomike, në shumë raste të pabarabarta, që të krijojnë të ardhura e t'i ndihmojnë të gjithë qytetarët. Mbështetja nga qeveritë për qytetarët dhe angazhimi i tyre së bashku është shumë me rëndësi për t'i përballuar efektet e pandemisë që nuk janë të vogla. Në fund do të duhej të bëhej edhe një bilanc përfundimtar, por është mirë që njëkohësisht dhe vazhdimisht të ndihmohen qytetarët dhe bizneset nga shtetet që të kalojnë sa më lehtë këtë sfidë të vështirë për njerëzimin.

(Autori është magjistër i Shkencave Ekonomike. Pikëpamjet e tij janë personale dhe nuk përfaqësojnë institucionin ku autori është i angazhuar, Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë, Administrata Tatimore, agjenci në kuadër të MF të Suedisë)



Përmes granteve nga Fondi i Mileniumit do të ndihmohen 25 gra ndërmarrëse në Gjilan

GJILAN, 1 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar një marrëveshje me drejtoreshën e organizatës HELP, Shqipe Breznica, për ndarjen e 25 granteve për gratë ndërmarrëse, që ka për qëllim rritjen e ndërmarrjeve përmes shfrytëzimit më eficient të energjisë. Me këtë rast, kryetari Haziri ka falënderuar organizatën HELP dhe drejtoreshën e saj, Shqipe Breznica, si pjesë e projektit që realizohet nga Fondacioni i Mileniumit në Kosovë, ku Gjilani është përfitues i

programit të dytë për sanimin dhe renovimin e objekteve private që, gjithashtu, ka të bëjë me kursimin e energjisë.

“Këto janë programe që do të na ndihmojnë shumë, në veçanti për gruan ndërmarrëse, për nënën, për kryefamiljaren e cila përfiton në kuadër të programit të Mileniumit, që Organizata HELP jep për Komunën e Gjilanit”, ka thënë Haziri.

Kurse Shqipe Breznica, drejtoreshë e organizatës HELP, tha se nga kjo skemë e granteve përfitojnë 25 gra ndërmarrëse për blerjen e pajisjeve të cilat kursejnë energji elektrike.

Gratë mund të aplikojnë pasi të hapet konkursi, ku përzgjedhja do të bëhet përmes një procesi transparent, ndërsa projekti realizohet në bashkëpunim dhe participim me Komunën e Gjilanit.

Ndërkaq Valbona Tahiri, drejtoreshë e Zhvillimit Ekonomik, tha se investimi në pajisje që kursejnë energji elektrike, për çka është i destinuar ky projekt, do t'i ndihmojë gratë për uljen e shpenzimeve operative dhe orientimin e atyre mjeteve pastaj për rritjen dhe zhvillimin e biznesit të tyre.



Shënohet 4-vjetori i themelimit të Qendrës së Autizmit në Podujevë



PODUJEVË, 1 SHKURT (ER) - Nënkryetarja e Komunës së Podujevës, Marigona Lahu, ka marrë pjesë në manifestimin e shënimit të katërvjetorit të themelimit të Qendrës së Autizmit në Podujevë.

Nënkryetarja Lahu, gjatë takimit me drejtoreshën e Qendrës, Arjeta Ukelli dhe bashkëpunëtorët e saj, përgëzoi stafin udhëheqës të kësaj qendre për punën që e bën për këtë kategori fëmijësh, socializimin dhe

integrimin e tyre në shoqëri. Me këtë rast, nënkryetarja Lahu u zotua se Komuna e Podujevës do të ofrojë mbështetje për këtë qendër, për trajnimin, rehabilitimin, arsimimin dhe zhvillimin social të këtyre fëmijëve.

Aliu liron nga detyra drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

FERIZAJ, 1 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, pas kërkesës së bërë, ka marrë vendim për lirim nga detyra të drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DShMS), Bekim Ademi. Me këtë rast, Aliu ka falënderuar drejtorin e deritanishëm të

DShMS-së, Bekim Ademi, për punën dhe kontributin e tij në kushte pandemie, që me përkushtim në punë, kompetencë profesionale, pastërti morale dhe vullnet të pakursyer, arriti ta drejtojë me sukses Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.



Kryhet një operacion bastisje, sekuestrohen armë zjarri dhe substancë narkotike

PRISHTINË, 1 SHKURT (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë së Prishtinës ka ngritur praninë policore dhe riorientuar shpërndarjen në terren me qëllim mbulimin e secilës zonë në funksion të parandalimit të rasteve kriminale dhe kapjen e të dyshuarve për rastet e tilla. Kjo prani është plotësuar edhe me veprime dhe masa operative specifike me ndikim të drejtpërdrejtë për rritjen e treguesve të zbulimit, ngritjen e nivelit të sigurisë si dhe mbajtjen e komunitetit tonë të

sigurt dhe larg dukurive kriminale.

Në këtë kuadër, pas marrjes së informacioneve të rëndësishme në rrugë operative, të hënën në orët e hershme të mëngjesit në rrugën “Ismet Krasniqi” në Prishtinë, policia ka kryer një operacion bastisjeje i cili ka rezultuar me gjetjen dhe sekuestrimin e dy revoleve të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm, 123 copë fishekë të kalibrave të ndryshëm, një sasi e konsiderueshme e

substancës së dyshuar (dyskohet të jetë kanabis) si dhe armë të ndryshme. “Policia ka shoqëruar për në stacionin policor A. M., mashkull, 58 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës, dhe ndaj tij është iniciuar rasti për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës dhe substancave psikotrope & analoge dhe në konsultim me prokurorin e shtetit i njëjti është proceduar më tej”, ka njoftuar Policia e Kosovës.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (16)

Shkalla e Parë në Nish: Ushtarët e pafajshëm dënon me 67 vjet burg



Lulzim SAHITI

Pas 12 ditë shqyrtimi kryesor, në Gjykatën Ushtarake të Nishit (IK-135/87, 28 janar 1987), në kolegjin e përbërë nga gjykatësi, kolonel Velko Miliq (serb), kryetar i kolegjit, gjykatësi nënkolonel Ramo Selimoviq (mysliman-boshnjak) dhe nga gjykatësit porotë: Kapiteni Sadik Mulaj (shqiptar), togeri Zvonimir Pazhin (kroat) dhe nga flamurtari i klasit të parë, Dimitrije Stojkovski (maqedonas), si anëtarë të kolegjit me pjesëmarrjen e Desanka Spasiqit, procesmbajtëse, shpalli aktgjykimin për tetë ushtarët e pafajshëm duke dënuar në "Emër të popullit", me gjithsej 67 vjet burg. Me këtë rast janë dënuar:


1. Rizah Xhakli - 15 vjet burg
 2. Abdylxhemil Alimani - 14 vjet burg
 3. Afrim Mehmeti - 10 vjet burg
 4. Pajazit Aliu - 10 vjet burg
 5. Shefqet Paçarizi - 5 vjet burg
 6. Enver Behluli - 4 vjet burg
 7. Rizo Alibashiq - 7 vjet burg
 8. Islam Mahmuti - 2 vjet burg
- Në dënimin e shqiptuar është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. Gjashtë të parëve që u dënuar me mbi 5 vjet u është vazhduar paraburgimi, ndërsa Enver Behluli dhe Islam Mahmuti u liruan nga paraburgimi. Trupi gjykues obligoi të gjithë të dënuarit që veç e veç t'i paguajnë shpenzimet e gjyqit në shumë prej 411 000 dinarësh. Gjatë shqyrtimit kryesor, më 28 janar 1988, në Gjykatën Ushtarake të Nishit, gjykatësi Velko Miliq dhe kolegji që përfaqësonte ky nuk u interesonte zbardhja e të vërtetës për ngjarjen e Paraqinit, por ata kishin vetëm një qëllim: të dënoheshin me çdo kusht shokët

e Aziz Kelmendit. Madje dëshira e flaktë e tyre dhe prokurorit Zhivotije Bojiq ishte nxjerrja e të akuzuarve shqiptarë përpara kordonit të pushkatimit, por këtë nuk ia mundësonte Kushtetuta e RSFJ-së.

Shkalla e Dytë në Beograd ua ngrit dënimet në 94.6 vjet burg

Të pakënaqur me vendimin e shkallës së parë të Gjyqit Ushtarak të Nishit, të akuzuarit parashtuan ankesë, e të njëjtën gjë e bënë edhe avokatët e tyre, të cilët kishin propozuar që të abrogohet aktgjykimi i shkallës së parë dhe e tërë lënda të kthehet në rishqyrtim, ndërsa disa kishin kërkuar lirimin e të akuzuarve dhe dënime të vogla për ta. Ndërsa prokurori ushtarak i Zonës Ushtarake të Nishit, Zhivotije Bojiq, në ankesën e tij (nr. 122/87, më 26. 02. 1988), prej tetë faqesh kishte thënë se gjyqi bëri gabim në përcaktimin e gabimeve ngaqë ato ishin të vogla në krahasim me veprën dhe kërkonte dënime më të rënda për të pandehurit.

Me këtë rast, trupi penal i Gjyqit Suprem Ushtarak në Beograd, më 18-19 prill 1988, ka bërë shqyrtimin publik gjatë dy ditëve lidhur me aktgjykimin e shkallës së parë të Gjyqit Ushtarak të Nishit. Seancën publike e kryesonte mr. gjeneralmajor Vojislav Shushunjar, kryetar i Gjyqit Suprem Ushtarak në Beograd. Në përbërje të trupit gjykues ishte edhe gjykatësi referues, koloneli dr. Jovan Buturovici, ndërsa gjyqtarë porotë ishin: Kolonel Marjan Debelak, kolonel Ali Aliu dhe kolonel Ervin Kovaçeviq. Në këtë gjykim, prokuror ushtarak, ishte gjeneralmajor Ahmet Hoxhiq. Në këtë seancë publike ishin të pranishëm edhe gjashtë të akuzuarit e parë: Rizah Gjajli, Abdylxhemil Alimani, Afrim Mehmeti, Pajazit Aliu, Shefqet Paçarizi e Rizo Alibashiq, të cilët



Aziz Kelmendi

në gjykatore po merrnin pjesë me rroba civile, pasi në mars të vitit 1988 u kaloi koha e shërbimit të afatit ushtarak. Dy të akuzuarit e tjerë, Enver Behluli e Islam Mahmuti, të cilët po ashtu ishin ankuar e të cilët po mbroheshin në liri, nuk u paraqiten në gjykatore edhe pse kishin qenë të ftuar.

Trupi penal i Gjyqit Suprem Ushtarak në Beograd (II-K Nr. 98/88, datë 20 prill 1988), në vend se të merr vendim për përsëritjen e gjykimit, "u ime naroda" (në emër të popullit) kishte shqiptuar dënime drakonike ndaj ushtarëve të pafajshëm shqiptarë:

1. Rizah Xhakli - 20 vjet burg
 2. Abdylxhemil Alimani - 20 vjet burg
 3. Afrim Mehmeti - 13 vjet burg
 4. Pajazit Aliu - 13 vjet burg
 5. Shefqet Paçarizi - 7 vjet burg
 6. Enver Behluli - 5.6 vjet burg
 7. Rizo Alibashiq - 14 vjet burg
 8. Islam Mahmuti - 2 vjet burg
- Dënimi i ushtarëve të pafajshëm në grup me gjithsej 94.6 vjet burg për "krim" të pabërë, pa pasur asnjë provë materiale, përveç dëshmive (deklaratave) të rrejshme edhe atë marrë me dhunë gjatë hetuesisë nga të akuzuarit, kishte qëllim vetëm e vetëm për ta përmbyllur këtë

proces gjyqësor me dënime drakonike.

Për procesin gjyqësor të Rastit Paraqini, në librin "Mbrojtësi" të autorë Valbona Mehmeti thuhet: "Në ankesën 29 faqe të cilën e dorëzoi, Bajram Kelmendi i zbërtheu aktakuzën dhe aktgjykimin duke i shpërfaqur aty të gjitha shkeljet ligjore, shtrembërimin dhe fshehjen e fakteve, dënimin e të akuzuarve mbështetur në deklaratat e marra me dhunë dhe në dëshmi të rrejshme. Me një fjalë, aty e çmontoi inskenimin që i kishin bërë gjithë rastit organet e ndjekjes". Megjithatë as kjo ankesë nuk bëri punë fare ngase Gjykata Supreme Ushtarake në Beograd kishte vendosur t'i dënonte mizorisht tetë djem të pafajshëm vetëm e vetëm për të kënaqur apetitet e nacionalistëve serbë.

Shkalla e Tretë në Beograd konfirmon dënimet


Duke pasur parasysh se ndaj këtij vendimi të Gjykatës Supreme Ushtarake në Beograd, brenda 15 ditësh kanë pasur të drejtë të bëjnë ankesë dy të akuzuarit e parë shqiptarë: Rizah Xhakli e Abdylxhemil Alimani kanë shfrytëzuar këtë mundësi të ankohen në Shkallën e Tretë. Avokati i Rizah Xhaklit, mbrojtësi Isa Mustafa dhe avokatët e Abdylxhemil Alimani, mbrojtësit: Savo Kocarev, Bekir Hyseni e Toma Fila, kanë bërë ankesë në gjykatën kompetente.

Për ta shqyrtuar ankesën e dy të dënuarve me 20 vjet burg, Rizah Xhakli e Abdylxhemil Alimani, pa praninë e tyre më 13 tetor 1988 (III K - 2/88) është mbajtur seanca e kolegjit të Gjykatës Supreme Ushtarake në Beograd, e kryesuar nga kolonel mr. Miroslav Stevanoviq, nënkolonel mr. Dimitrije Pavlovic, gjyqtarë porotë: Nënkolonel Xhemail Bejta, nënkolonel Aleksander Krstevski, nënkolonel Kristo Kneziq dhe majori Josip Farçiq, të cilët kanë

vërtetuar aktgjykimin e Shkallës së Dytë, në 59 faqe, ku procesmbajtës ishte kapiteni Goran Daloviq.

Rishqyrtimi i jashtëzakonshëm në Gjykatën Federative në Beograd

Ndërsa avokatët e të dënuarve në Procesin e Paraqinit kishin shfrytëzuar mjetin e fundit juridik duke bërë kërkesë për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të aktgjykimit të formës së prerë. Me këtë rast, Gjykata Federative në Beograd, më 30 qershor 1989 (Kps - 129/88), në një panel të përbërë nga gjyqtarë: Obrad Cvijeviq, kryetar i trupit gjykues, Petar Gvozdenoviq, mr. Stefan Horvat, Faruk Presheva dhe Rajko Nishaviq, anëtarë të trupit gjykues, me këshilltarin gjyqësor mr. Olga Borçiq, si procesmbajtës, kanë konfirmuar dënimet për Rizah Xhaklin dhe Abdylxhemil Alimani, me arsyetimin (10 faqe) se kërkesat për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjyqimeve të plotfuqishme janë të pabaza. Me gjithë dënimin e rëndë që kishte marrë i riu Rizah Xhakli bashkë me shokët tjerë, organet e atëhershme komunale në Ferizaj nuk ishin të kënaqur me kaq por Sekretariati për Punë të Brendshme i Kuvendit të Komunës së Ferizajt, më 11. 11. 1987, Rizah Xhakli ia merr edhe pasaportën për udhëtim. Atij, pasaporta i ishte marrë në bazë të urdhërësës së Gjykatës Ushtarake në Nish, nr. KI-105/87, më 19. 10. 1987, bëhet e ditur nga Aktvendimi i lëshuar nga Drejtorati për Eliminimin e Kriminalitetit, i nënshkruar nga Stanjko Staletoviq. Gjithashtu, Xhakli ishte përjashtuar edhe nga Njësi Profesional i Zjarrfikësve në Ferizaj. Në këtë vend të punës ai punonte para se të shkonte ushtar, mirëpo është larguar nga vendi i punës. Ky vendim ishte nënshkruar nga sekretari i Sekretariatit, Hysni Islami. (Vijon)





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Drenica, klubi më aktiv në afatin e janarit

Klubet elitare të futbollit në Kosovë kanë qenë mjaft aktive në afatin kalimtar të janarit, pasi kanë kryer rreth 40 transferime. Pranvera pritet të jetë shumë interesante në garën për titull të kampionit dhe në ndeshjet për mbijetesë, derisa garë e fortë pritet të jetë edhe për kupë



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 SHKURT - Rreth 40 transferime janë bërë nga klubet e Superligës së Kosovës në futboll gjatë afatit kalimtar të janarit. Klubi më aktiv ka qenë skuadra e Drenicës nga Skenderaj. Kuqezinjtë, me synim për ta siguruar mbijetesën, janë përforcuar me dhjetë futbollistë, në mesin e tyre emra të njohur në futbollin e Kosovës si Kreshnik Uka dhe Kreshnik Lushtaku, të cilët edhe në të kaluarën e kanë djersitur fanellën kuqezi. Nga ky klub janë larguar dhjetë futbollistë të tjerë. Mjaft aktive ka qenë edhe skuadra e Llapit që ka transferuar gjashtë futbollistë, ku spikat transferimi i portierit Marian Coriç, kurse kjo skuadër ka larguar pesë futbollistë të tjerë. Kampionia në fuqi dhe liderja e Superligës, Drita, ka angazhuar dy lojtarë nga jashtë, kurse e ka huazuar një futbollist. Skuadra nënkampione e vjeshtës, Ballkani, ka bërë tri përforcime, në mesin e tyre Diar Miftaraj. Prishtina, e cila ditë më parë e rrëmbeu Superkupën, ka rikthyer Ardit Nikën dhe ka liruuar shumë futbollistë, derisa Gjilani ka befasuar me rikthimin e Qëndrim Dautajt. Klubi që drejtohet nga Bylbyl Sokoli e ka transferuar edhe mbrojtësin Ardin Dallku. Transferime kanë kryer edhe skuadrat e tjera elitare, me shpresën për t'i arritur objektivat që kanë në sezonin pranveror.

FC Drita

Ardhje: Esosa Priestley Irogue, Henry Onoka Austine
Largime: Valmir Azemi (huazim)

FC Ballkani

Ardhje: Diar Miftaraj, Arbër Shala, Damir Ljuljanoviq
Largime: Durim Gashi, Armend Rugji, Rroni Gashi, Liridon Fetahaj, Leorant Marmullaku, Melos Bajrami, Armin Bosnjak, Albin Berisha (huazim), Endrit Asllanaj (huazim), Bleon Sekiraqa (huazim te Malisheva), Albin Kapra (huazim)

FC Prishtina

Ardhje: Ardit Nika
Largime: Ivan Jeliç, Nikson Mema, Ahmed Raddaoui, Donat Hasanaj, Kreshnik Uka (huazim), Dhurim Zhuri (huazim)

SC Gjilani

Ardhje: Qëndrim Dautaj, Ardin Dallku, Drin Govori
Largime: Gramoz Kurtaj, Erlis Frashëri, Jackson Ferreira, Albin Halimi (huazim), Lavdrit Mehmeti (huazim), Muhamed Dubova (huazim)

FC Feronikeli

Ardhje: Damir Kojaseviq, Simon Loshi
Largime: Viktor Kuka, Alban Pnishi, Argjend Bardhi, Ozbej Kuhar, Marcelei Cezar - Santos, Ardi Qorri (huazim)

KF Arbëria

Ardhje: Marcelei Cezar - Santos, Elmir Lekaj, Aldin Adzovic, Anes Hot, Andi Seferi
Largime: Rilind Gërbeshi, Filonit Shaqiri, Gëzim Rusi, Kujtim Qeli, Sunaj

Hasan, Lutfi Bilalli, Arbnor Gashi, Korab Hasani

FC Trepça '89

Ardhje: Albin Kapra (huazim), Nikson Mema
Largime: Albert Kaqiku, Ervin Kaçar, Kreshnik Nebiu

FC Llapi

Ardhje: Almedin Klinaku, Ilir Krasniqi, Marian Coriç, Enis Stublla, Amir Hossari, Drilon Ajeti
Largime: Bekim Maliqi, Arlis Shala, Eglentin Gjoni, Steven Hoffman, Rilind Gërbeshi (huazim)

FC Drenica

Ardhje: Behar Ramadani, Eglentin Gjoni, Donald Rapo, Dionis Cikani, Dardan Rugova, Erlis Frashëri, Kreshnik Uka (huazim), Klevis Shaqe, Kreshnik Lushtaku, Harallamb Qaqi
Largime: Almedin Murati, Albutrint Morina, Arbios Thaçi, Diar Miftaraj, Ehat Gjoka, Flamur Kadriu, Jeton Dushi, Lulzim Doshlaku, Muharrem Musa, Valto Zeqaj dhe Vildan Kerim

FC Besa

Ardhje: Bekim Maliqi, Diellor Beseni, Ardi Qorri (huazim nga Feronikeli), Erjon Morina, Guri Hana, Dhurim Zhuri (huazim nga Prishtina)
Largime: Filip Sekiç, Florent Qorraj, Matheus de Paula, Lucas Sebastian, Breno Barbosa Matos, Norik Krasniqi, Arbër Maznikolli (huazim), Andi Alshiqi (huazim)

SHKURT

Vëllaznimi, pas tetë humbesh radhazi, e shkarkon trajnerin

KB Vëllaznimi e ka shkarkuar Ljupce Malinkovin nga detyra e trajnerit. Klubi kuqezi deri te ky vendim ka ardhur pasi ka humbur tetë ndeshjet e fundit. "Pas një serie prej tetë humbjeve, kryesia e klubit, në marrëveshje të dyanshme me trajnerin Ljupce Malinkov, kanë shkëputur bashkëpunimin. Klubi e falënderon trajnerin për kontributin e dhënë. Për momentin klubi do të jetë nën udhëheqjen e trajnerit Shkumbim Kumnova, kurse të angazhojë një trajner tjetër", thuhet në njoftimin e KB Vëllaznimi.

Avdyli nga Trepça '89 transferohet në Zvicër

FC Aarau ka nënshkruar me Milot Avdylin nga Trepça '89. 18-vjeçarin ka nënshkruar në një kontratë për dy vjet e gjysmë. Avdyli me skuadrën mitrovicase luajti gjithsej 25 ndeshje (katër gola, pesë asistime) në Superligën e Kosovës vitin e kaluar. Përveç kësaj, ai është thirrur rregullisht për ekipet e të rinjve të Kosovës (aktualisht: U-19) në vitet e fundit. Lojtari ofanziv ka qenë në Aarau që nga fillimi i vitit dhe u përdor në dy ndeshjet përgatitore kundër FC Basel dhe BSC Young Boys.

Werderi refuzon ofertën e Herthas për Rashicën

Të dielën është raportuar se Hertha Berlini e dëshiron yllin e Kosovës dhe të Werder Bremenit, Milot Rashica. Mirëpo klubi i Bremenit të hënën e ka refuzuar ofertën e Herthas për ta liruuar sulmuesin anësor në formë huazimi, por synim i kësaj skuadre është shitja e Rashicës për 15 milionë euro. Rashicën më herët e kanë kërkuar edhe Bayer Leverkuseni, Aston Villa dhe RasenBallSport Leipzig.

Kemal Ademi huazohet te Karagumruku

Sulmuesi Kemal Ademi ka ndërruar ambient këtë afat kalimtar dimëror. Ai ka kaluar nga Fenerbahçe në Karagumruk. Lajmin e ka bërë me dije vetë klubi i Fenerbahçes përmes një postimi në llogarinë në "Twitter". Ademi shkon në Karagumruk në formë huazimi deri në fund të sezonit. Reprerentuesi zviceran arriti në Fenerbahçe verën e kaluar nga ekipi zviceran Basel. Deri tash ai është paraqitur vetëm 10 herë në të gjitha garat, ndërsa ka realizuar një herë në Kupë dhe ka bërë një asistim në ligë.

Fury: Jam më i kompletuar se Joshua, e mposhti pa problem

MANCHESTER, 1 SHKURT - Boksieri britanik Tyson Fury, kampion bote në peshën e rëndë (kategoria WBC), u shpreh se do ta fitojë duelin që do të zhvillojë me patriotin Anthony Joshua. Edhe ky i fundit është kampion bote në kategorinë WBA, WBO

dhe IBF. Fury mendon se është më i madh, më i fortë dhe më i shkathët se Joshua, cilësi këto që do ta ndihmojnë për përballet me tyre. Kjo sfidë, me shumë gjasa, do të zhvillohet në qershor të këtij viti dhe do të unifikojë titujt

kampionë bote. "Ndaj Joshuas do të veprojmë njësoj si ndaj Wilderit. Thashë se do të shkoja drejt tek ai e do ta grushtoja dhe ashtu bëra, duke e bombarduar derisa sfida u ndal", ka thënë Fury, i pamposhtur në karrierën e tij. "Unë fitoj pasi kam një

zemër më të madhe, jam më i fortë fizikisht, jam më i fortë psikologjikisht, grushtoj më fort se Joshua. Jam më i kompletuar se ai. Kur të përballet me mua do ta kuptojë atë që them. Ai nuk ka asnjë shans të fitojë ndaj meje. Unë jam dhe do të



mbetem i pamposhtur, i pashkatërrueshëm", ka deklaruar Fury.

Të mërkurën fillon gara për trofeun e çmuar

PRISHTINË, 1 SHKURT - Këtë javë palestra "13 Qershori" do të jetë arenë e ndeshjeve të "Final 8" Kupës së Kosovës Vllasa & Pagesa. Tetë skuadrat e Superligës së meshkujve, dy finalistet në konkurrencën e femrave dhe katër skuadrat e Ligës së Parë të meshkujve, do të garojnë për trofetë e çmuar në basketbollin e Kosovës.

Nga dita e mërkurë deri të dielën pritet spektakël i basketbollit me shumë përballe interesante dhe dramatike. Sfidat fillojnë të mërkurën, ku Rahoveci do të përballet me Trepçën. Këto dy skuadra ishin ballafaquar edhe vitin e kaluar, ku "Vreshtarët" kaluan tutje në një sfidë shumë dramatike. Trofeu i Kupës është shumë i dëshiruar për të dyja skuadrat, që do ta japin maksimumin për të triumfuar dhe për t'u kualifikuar në gjysmëfinale. Golden Eagle Ylli - Bashkimi është sfida tjetër që po pritet me interesim të madh. Therandasit janë më favoritë, por prizrenasit nuk dorëzohen dhe synojnë të arrijnë sa më lart. Bashkimi kishte arritur edhe në finale të Superkupës, ku ishte mundur nga Sigal Prishtina. Ponte Prizreni dhe Vëllaznimi përballen të enjten, me të dyja skuadrat që duan kualifikimin tutje, ndërsa sfida e fundit çerekfinale është mes



rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës, Pejës dhe Sigal Prishtinës.

Pejanët fituan Kupën edicionin e kaluar, kurse prishtinasit janë skuadra më e trofeshme në vend, dhe sigurisht duan të shtojnë edhe një trofe në sirtar. Ndeshjet gjysmëfinale do të zhvillohen të premtën, kur do të zhvillohet edhe finalja e Kupës në Ligën e Parë. Ndërkohë, të dielën, më 7 shkurt, do të jetë dita e finaleve. Derisa në konkurrencën e meshkujve finalistët ende nuk janë përcaktuar, në konkurrencën e femrave do të përballet Prishtina dhe Bashkimi. Këto dy skuadra në vitet e fundit kanë luftuar për trofe, si në Kupë, Superligë dhe Superkupë, andaj pritet një sfidë shumë interesante mes këtyre dy skuadrave me traditë në basketbollin e Kosovës. Me

ORARI

Të mërkurën takohen:
13:00 Istogu - RC Cola Drita
16:00 Grupi B: Rahoveci - Trepça
18:30 Hapja solemne
19:00 Grupi C: Golden Eagle Ylli - Bashkimi

Të enjten takohen:
13:00 Marigona Hill Prishtina - AS Prishtina
16:00 Grupi D: Ponte Prizreni - Vëllaznimi
19:00 Grupi A: Peja - Sigal Prishtina

Të premtën takohen:
13:00 Finalja: Kupa e Ligës së Parë
16:00 Gjysmëfinalja e I (Fituesit e grupit B-C)
19:00 Gjysmëfinalja e II (Fituesit e grupit D-A)

Të dielën takohen:
14:00 Finalja e Femrave
17:30 Finalja e Meshkujve

përforcimet që kanë bërë, të dyja skuadrat do të luftojnë deri në fund për të triumfuar në Kupë.

Anglia rrezikon të humbasë eliminatorët për Botërorin 2022

LONDËR, 1 SHKURT - Masat ekstreme që po merr qeveria britanike kundër Covid-19 e rrezikojnë edhe kombëtaren e "3 luanëve" për eliminatorët e Botërorit 2022. Lajmin e bujshëm e publikon e përditshmja angleze "The Sun". Sipas kryetarit të Partisë Laburiste, Sër Keir Starmer, kushdo që shkon në Angli duhet të kryejë një karantinë 10-ditore nëpër hotele, kushdo qoftë, edhe sportistët profesionistë. Nëse do të miratohen këto masa ekstreme atëherë përfaqësuesja angleze e futbollit do ta rrezikojë edhe pjesëmarrjen në Botërorin Katar 2022, pasi nuk do të arrinte të luante për ndeshjet në grup që ka kundër



Shqipërisë, Polonisë dhe San Marinos. Nëse ndodh kjo, Anglia do t'i humbiste ndeshjet në tavolinë me rezultatin 3-0 dhe nuk do të ishte e mundur të merrte pjesë

në Botëror. Veç kësaj, një kaos do të shkaktonte edhe për Evropianin që pritet të zhvillohet këtë verë, apo ndeshjeve të Ligës së Kampionëve apo Formula 1.

SHKURT

Neymari: Jam i lumtur në PSG, nuk largohem

Futbollisti i Paris Saint Germainit, Neymar, ka folur pas humbjes së djeshme që skuadra e tij e pësoi në kuadër të xhiros së 22-të të Ligës 1 nga Lorienti. Neymari shënoi dy gola në këtë ndeshje, por nuk i mjaftuan skuadrës që t'i arketojë pikët. Neymari, duke folur për "TF1", u shpreh i lumtur që është pjesë e PSG-së dhe shpreson që edhe Mbappe të qëndrojë. "Jam shumë i lumtur këtu, ndihem mirë dhe jam adoptuar, jam i qetë. Jam i lumtur dhe dua të mbes këtu në PSG. Shpresoj që edhe Kilyan Mbappe të qëndrojë. Natyrisht kjo është dëshira e tifozëve dhe duam që PSG të mbesë një skuadër e madhe. Dëshirojmë të vazhdojmë kështu dhe ta japim maksimumin për klubin", ka thënë Neymari.

Griezmann: Messi është një legjendë

Antoine Griezmann e ka lavdëruar Lionel Messin pasi detajet e fitimeve të tij në Barcelona u zbuluan një natë para ndeshjes kundër Athletic Bilbaos. Sulmuesi francez ka thënë se Messi është një legjendë. "Ne jemi duke shijuar Leo Messin. Ai është një legjendë", ka thënë Griezmann. Griezmanni dhe Messi ishin golashënues në ndeshjen që Barcelona e fitoi të dielën kundër Athletic Bilbaos (2-1).

Tosuni huazohet te Beshiktashi

Sulmuesi Cenk Tosun e ka kompletuar kalimin nga Evertoni te Beshiktashi në formë huazimi deri në fund të sezonit. Tosuni në vitin 2018 ishte transferuar te skuadra e Evertonit nga Beshiktashi për 27 milionë euro, por nuk ka arritur asnjëherë të dëshmojë dhe ishte i huazuar edhe në Crystal Palace. Repreruesi turk ka luajtur edhe për Gaziantepsporin dhe Eintracht Frankfurtit.

Piloti i Formulës 1 infektohet me Covid

Piloti francez Pierre Gasly, që garon në Formula 1 me makinën Alpha Tauri, ka konfirmuar se ka dalë pozitiv me koronavirus. Ai e dha lajmin përmes një postimi në rrjetet sociale, duke shtuar se ndihet mirë. "Përhëndetje të gjithëve! Uroj të jeni të gjithë mirë e të sigurt. Dua të ndaj me ju lajmin se kam rezultuar pozitiv me Covid-19. Kam informuar këdo që ka qenë në kontakt me mua ditët e fundit. Jam izoluar menjëherë dhe po ndjek procedurat e sigurisë që kanë vendosur autoritetet shëndetësore. Do ta vijoj stërvitjen në shtëpi gjatë kësaj kohe që jam në karantinë", ka shkruar Gasly, i cili është piloti i gjashtë në Formula 1 që infektohet me koronavirus.

Pensionohet Afellay

U trumbetua me të madhe se do të ishte një nga talentet më premtues të futbollit, por Ibrahim Afellay nuk arriti të ngrihej kurrë në nivelin e pretenduar. I pafat edhe për shkak të dëmtimeve, holandezi ka vendosur së fundmi, në moshë 34-vjeçare, t'i varë "këpucët në gozhdë", duke hequr dorë nga futbollin e luajtur. Afellay debutoi në vitin 2004 në PSV, teksa më pas bëri transferimin e jetës duke kaluar te Barcelona por, për fat të keq, rezultoi një zhgënjim. Me katalanasit mesfushori u aktivizua 21 ndeshje dhe shënoi vetëm një gol. Më pas holandezi u huazua te Schalke dhe Olimpiacos, por pa mundur të lërë gjurmë. Stoke dhe PSV ishin dy destinacionet e fundit në karrierën e tij. Prej muajit qershor ishte pa skuadër, teksa tashmë vendosi të tërhiqej përfundimisht. 34-vjeçari arriti të fitonte disa trofe, ndërkohë që regjistroi edhe 53 paraqitje me Kombëtaren A të Hollandës.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



ISBN 978-9951-780-37-7

9 789951 780377




AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



ISBN 978-9951-780-10-0


9 789951 780100

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë






Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA


Tel: +377 45 400 156 | +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim




044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi



NJOFTIM

Licencimi i Aktivitetit të Furnizimit me Shumicë (Tregtimit) të Energjisë Elektrike në Kosovë

10000 Prishtine; Kosove: Lagje Mati 1, Rr. Rexhep Krasniqi, banesa 9-1

"ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C. Rruga Lagje Mati 1 Rr. Rexhep Krasniqi, banesa 9-1, Prishtinë, Republika e Kosovës, në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj **NJOFTON** palët e interesit se ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji për licencim të aktivitetit të **Furnizimit me Shumicë (Tregtimit) të energjisë elektrike në Kosovë**. Aplikacioni për licencim të këtij aktiviteti me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjës të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimmarrje.

Licencimi i furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike i ndërmarrjes **"ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C.** përveç tjerash do të përmbajë:

- Territori i mbuluar nga Licenca është Republika e Kosovës.
- I licencuari ka të drejtë të blejë kapacitete dhe energji elektrike nga prodhuesit me çmime të parregulluara
- blejë dhe shes kapacitete dhe energji elektrike nga furnizuesit tjerë me çmime të parregulluara;
- shes kapacitete dhe energji elektrike furnizuesve tjerë me çmim të parregulluar; dhe
- transitojë, importojë dhe eksportojë kapacitete dhe energji elektrike.

I licencuari mund të kryej aktivitetin e furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike në pajtim me dispozitat e Licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë. Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. "Dervish Rozhaja", Nr. 12, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: hrexhaj@ero-ks.org; Tel.038247615/118.

Energy Financing Team L.L.C.
10000 Prishtine; Kosove: Lagje Mati 1, Rr. Rexhep Krasniqi, banesa 9-1,

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Enis Kurtaj shpall të pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Faik Bajrami shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Argumend Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.
- ▶ Nderim Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.
- ▶ Edi Elshani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.
- ▶ Edmona Hoxha shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme të ulët "Nexhmi Mustafa" Prugofc Prishtinë.
- ▶ Kemal Dilji shpall të pavlefshme dëftesat shf " Shari " Jabllanic.
- ▶ Ylber Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Miftar Omaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.
- ▶ Doruntina Zogiani shpall të humbur diplomën e Fakultetit të FSHMN-së drejtimi Fizikë -arsimore, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", data e lëshimit diplomës 12 shkurt 2007.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

